

1032
11412



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1039/1 Prot.

Tiranë, më 25.7 2017

Lënda: *Përgjigje në kuadër të trajtimit të kërkesës së paraqitur nga ana juaj.*

Drejtuar: Qendrës "Res Publica"
Z. Dorian MATLIJA
Blv "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.44

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka marrë në shqyrtim kërkesën tuaj, administruar pranë KDIMDP me nr. 1039 prot. datë 19.07.2017, lidhur me publikimin e një liste me emra në faqen e Facebook të Kryeministrit, në datë 12.07.2017. Pas vlerësimit të kësaj kërkesë, ju vijmë në ndihmë me sqarimin e mëposhtëm:

Në trajtimin e rastit të paraqitur është e nevojshme që të bëhet referencë në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Për pasojë, pretendimet sa i përket respektimit të të drejtave të garantuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar mund të ngrihen vetëm nga subjektet e të dhënave personale pasi janë të drejta që lidhen ekskluzivisht me të. Në kushte të tilla, në mungesë të një ankese, Zyra e Komisionerit nuk ka ndërmarrë masa deri në këto momente.

Megjithatë, me qëllim qartësimin e kësaj situate dhe në respekt të angazhimit tuaj, Zyra e Komisionerit sqaron se nuk ka juridiksion mbi rrjetin "Facebook", pasi ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, mbi të cilin mbështetet veprimtaria e Komisionerit, zbatohet në rast të përpunimit të të dhënave personale nga kontrollues të vendosur në Republikën e Shqipërisë. "Facebook" është një rrjet social që vepron sipas disa "Kushteve dhe Politikave" të përcaktuara dhe të publikuara online në adresat: (www.facebook.com/policies?ref=pf), (www.facebook.com/privacy/explanation), të cilave duhet t'i referohet çdo person që ka ndonjë pretendim të mundshëm.

Në këto kushte, konstatimi i mungesës së një rregullimi ligjor tjetër mbi veprimtarinë e portaleve online të këtij lloji, e bën të pamundur për Zyrën e Komisionerit trajtimin e mëtejshëm të ankesës suaj.

Pjerina GAXHA

DREJTORE